



# Buletini mujor

Dhjetor 2025



Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, gjatë takimit me kryetarët dhe përfaqësuesit e institucioneve homologe

## Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu priti në takim drejtuesit e institucioneve homologe

Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu priti në një takim pune më 5 dhjetor, kryetarë dhe përfaqësues të tjerë të Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) të Ballkanit Perëndimor dhe Moldavisë.

Z. Shehu i falënderoi për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre në këtë takim, si dhe shprehu vullnetin e plotë për të vijuar dhe thëlluar më tej bashkëpunimin e ndërsjellë, jo vetëm në kuadër të projektit "Smart Finance" për një "Qeverisje të Përgjegjshme", por edhe më gjerë, me auditime të cilat do të kenë në fokus çështje që trajtojnë problematika të rëndësishme dhe që janë të përbashkëta për vendet e rajonit tonë.

Drejtuesit dhe përfaqësuesit e SAI-ve falënderuan Kryetarin e KLSH-së për organizimin e takimit dhe idetë e shprehura, duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të SAI-ve të rajonit, për të vijuar me iniciativa të përbashkëta në të ardhmen.

Në datat 4-5 dhjetor 2025, Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, së bashku me kryetarë dhe përfaqësues të Institucioneve Supreme të Auditimit nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Moldavia si dhe partnerë nga Zyra Supreme e Auditimit të Sllovakisë morën pjesë në dialogun rajonal të organizuar në Tiranë nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), në kuadër të nisjes së projektit "Smart Finance" për një "Qeverisje të Përgjegjshme".

Gjatë takimit 2-ditor u zhvilluan diskutime mbi rolin e auditimit në mbështetjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), sfidat në qeverisjen vendore dhe rëndësinë e forcimit të mekanizmave të transparencës dhe llogaridhënies. Pjesëmarrësit ndanë përvoja mbi auditimet e OZHQ-ve dhe mënyrat për integrimin e tyre në auditimet e performancës, duke theksuar nevojën për qasje të harmonizuara dhe përdorimin e metodologjive të përbashkëta në rajon.

U prezantua gjithashtu drafti i parë i "Vlerësimit të Nevojave të Kapaciteteve të SAI-ve", i cili evidenton fusha ku kërkohet asistencë teknike, trajnim dhe shkëmbim përvojash, duke shërbyer si bazë për hartimin e planit të punës për vitin 2026. Pjesëmarrësit u njohën edhe me praktikën e Zyrës Supreme të Auditimit të Sllovakisë, përfshirë përdorimin e mjeteve digjitale si platforma "MUMAP", të cilat paraqesin mundësi për t'u adaptuar në rajon në funksion të auditimit vendor.

Në këtë kuadër, z. Shehu vlerësoi bashkëpunimin rajonal dhe theksoi angazhimin e KLSH-së në mbështetjen e proceseve të auditimit të orientuara drejt OZHQ-ve, duke synuar rritjen e efektivitetit të qeverisjes publike në nivel qendror dhe vendor.

Aktiviteti u mbyll me dakordësimin për zhvillimin e një plani të përbashkët pune për vitin e ardhshëm, i cili do të udhëheqë veprimtaritë e projektit dhe bashkëpunimin ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit në rajon, me synimin për të forcuar kapacitetet, transparencën dhe llogaridhënien në menaxhimin e fondeve publike.



# Kryetari i KLSH-së zhvillon takim me Auditorin e Përgjithshëm të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Maqedonisë së Veriut, z. Maksim Acevski

Më 3 dhjetor 2025, Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu zhvilloi një takim me Auditorin e Përgjithshëm të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Maqedonisë së Veriut, z. Maksim Acevski dhe delegacionin që e shoqëronte, z. Orhan Ademi, zv. Auditor i Përgjithshëm, znj. Tanja Janevska, këshilltare dhe znj. Hristina Dabeska, audituese.

Gjatë takimit, z. Shehu dhe z. Acevski vlerësuan edhe një herë marrëdhëniet e frytshme dhe të qëndrueshme ndërmjet dy institucioneve duke e vënë theksin në konsolidimin e bashkëpunimit të ndërsjellë, veçanërisht në fushën e auditimeve paralele, ku të dy institucionet janë angazhuar duke pasur në fokus tematika të ndjeshme dhe me impakt shoqëror.

Angazhimi i dyanshëm do të vijojë edhe në të ardhmen, jo vetëm në nivel bilateral, me qëllim forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve respektive profesionale, por edhe nëpërmjet pjesëmarrjes në disa programe rajonale, në bashkëpunim me partnerë të tjerë ndërkombëtarë.



## Rritja e ndikimit të auditimit të jashtëm - Nis projekti i “Aktiviteteve Zhvillimore” të EUROSAT-t



Zyra Kombëtare e Auditimit e Suedisë (SNAO) organizoi në Stamboll nga data 2 deri më 5 dhjetor 2025, workshop-in ndërkombëtar “EUROSAT Development Activities Project launch and Audit Impact Workshop”, një aktivitet i rëndësishëm që shënoi nisjen zyrtare të projektit të ri zhvillimor të EUROSAT-t.

Në këtë aktivitet, KLSH u përfaqësua nga znj. Xhesila Nano, drejtor i Drejtorisë së Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, znj. Valdete Berisha, kryeauditues në Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Shtetit dhe znj. Xhuljeta Çelaj, kryeauditues në Departamentin e Auditimit të Performancës. Në workshop morën pjesë përfaqësues nga Institucionet Supreme të Auditimit të Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Turqisë, Kazakistanit, Bosnjë-Hercegovinës, Ukrainës, Moldavisë, Serbisë, Malit të Zi dhe Gjeorgjisë.

Workshop-i u fokusua në ciklin e auditimit, duke trajtuar të gjithë procesin nga planifikimi deri te raportimi, komunikimi i rezultateve dhe menaxhimi i cilësisë. Pjesëmarrësit u njohën me objektivat e projektit “Aktiviteteve Zhvillimore” (Development Activities - EDA), pritshmëritë për rezultatet e përbashkëta dhe mënyrat e koordinimit brenda rrjetit EUROSAT, në drejtimin teknik të SNAO-s.

Përfaqësuesit e KLSH-së kontribuan në diskutimet teknike të workshop-it duke paraqitur praktikat dhe qasjet në auditimet e performancës, financiare dhe të përputhshmërisë dhe në përmirësimin e cilësisë së auditimeve.

Gjithashtu, në sesione u trajtua gjerësisht roli i komunikimit dhe raportimit strategjik në rritjen e ndikimit të auditimit. U nënvizua se gjetjet e auditimit marrin vlerë të plotë vetëm përmes komunikimit të qartë dhe përdorimit efektiv nga institucionet dhe publiku. Në ditën e fundit, pjesëmarrësit u fokusuan në menaxhimin e cilësisë dhe zhvillimin e hapave të mëtejshëm për hartimin e planit të projektit EDA, një dokument që do të udhëheqë fazën e implementimit dhe aktivitetet e përbashkëta të EUROSAT-t për vitet në vijim.

Pjesëmarrja e KLSH-së në këtë aktivitet forcon angazhimin e institucionit për të ndjekur standardet dhe praktikat më bashkëkohore të auditimit publik, për të rritur cilësinë dhe ndikimin e auditimeve dhe për të kontribuar në zhvillimin profesional të rrjetit EUROSAT. Workshop-i ofroi një platformë bashkëpunimi mes institucioneve dhe mundësi për shkëmbim njohurish dhe përvojash.

# Auditimi mbi “Masat e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse për eliminimin e derdhjes së ujërave të përdorura në Lumin e Lanës në Tiranë”



Lana, në stacionin e monitorimit Lanabregas



Lana, në stacionin e monitorimit në Kashar

Departamenti i Auditimit të Performancës në KLSH ka përfunduar auditimin mbi “Masat e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse për eliminimin e derdhjes së ujërave të përdorura në lumin e Lanës në Tiranë”.

Nga ky auditim ka rezultuar se ndotja e lumit të Lanës në kryeqytet i tejkalon ndjeshëm standardet kombëtare dhe të Bashkimit Evropian (BE), kriteret e Direktivës së BE-së për trajtimin e ujërave të ndotura urbane dhe udhëzimet globale të cilësisë së ujit, çka e bën atë lumin e dytë më të ndotur në Shqipëri (pas lumit Gjanica në Fier), referuar Raporteve të Gjendjes në Mjedis të publikuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Nivelet e tilla të ndotjes së ujërave të këtij lumi përbëjnë kërcënim për shëndetin publik, ekosistemet dhe cilësinë e jetesës për popullatën e Tiranës dhe zonave përreth.

Ndotja kryesore në lumin e Lanës vjen nga shkarkimet e ujërave të ndotura urbane, mbetjet urbane, industriale, ndërtimet pa leje që ngushtojnë rrjedhën e lumit; erozioni i tokës dhe dëmtimi i ekosistemit lumor. Monitorimet tregojnë nivele të larta të metaleve të rënda, materieve organike dhe ndotësve të tjerë fiziko-kimikë.


Sistemi i kanalizimeve të ujërave të qytetit të Tiranës është një sistem i kombinuar që përfshin ujërat e bardha dhe ato të përdorura urbane dhe industriale. Që nga viti 1964, rrjeti i ujërave të ndotura të qytetit të Tiranës është projektuar dhe ndërtuar në mënyrë të tillë që ky sistem të derdhet në mënyrë të drejtpërdrejtë në lumin e Lanës. Nga UKT sh.a. bëhet me dije se numri i pikave të shkarkimit të kolektorëve që shkarkojnë në këtë lumë është afërsisht 85, sa i përket segmentit të sistemit të shtratit të këtij lumi nga Shkoza e deri të “Pallati me Shigjeta”.

Nga të dhënat e administruara nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe nga Raportet e Gjendjes në Mjedis të publikuara, rezultoi se vazhdimisht që nga viti 2010 e deri në vitin 2024, gjendja mjedisore e lumit Lana ka pasqyruar një nivel të konsiderueshëm ndotje. Situata ka mbetur thuajse e pandryshuar në stacionin e monitorimit L 2 – ish-Dogana, i klasifikuar vazhdimisht në Klasën V – “Gjendje e keqe”. Ndërkohë, situata është përkeqësuar në stacionin e monitorimit L 1 – Lanabregas, pavarësisht se ky stacion është i caktuar në fillim të rrjedhës së lumit dhe paraprind zonën e urbanizuar të qytetit të Tiranës. Për monitorimin e vitit 2024, të dy stacionet rezultojnë të vlerësuar në Klasën V – “Gjendje e keqe”.


Gjendja aktuale e rrjetit të tubacioneve kryesore që shkarkojnë ujëra të ndotura direkt në lumin e Lanës paraqitet në fotot e mëposhtme:




## Të dhënat 2010 – 2023 mbi nevojën biokimike për oksigjen




## Të dhënat 2010 – 2023 mbi nivelin e oksigjenit të tretur




## Të dhënat 2010 – 2023 mbi nivelin e amoniakut



## Të dhënat 2014 – 2023 mbi nivelin e ortofosfateve (PO4)



## Të dhënat 2010 – 2023 mbi nivelin e fosforit total



## Mbi ndikimin në ujitje

Një nga risqet e tjera që paraqet ndotja e lartë e lumit të Lanës është edhe në ujitje, pasi "në basenin e Ishmit, në përgjithësi, ujërat sipërfaqësore konsiderohen si burim kryesor për ujitje, me lumenjtë Ishëm dhe Zezë si burime kryesore". Sipas MBZHR-së, sipërfaqja e tokës bujqësore në basenin e lumit Ishëm është rreth 26,000 ha dhe sipërfaqja ku fermerët kanë akses në ujitje është rreth 8,000 ha.

## Mbi ndikimin në mjedis

Përpos ndikimeve mjedisore, estetike etj., në qytetin e Tiranës, ku edhe kalon në pjesën më të madhe të shtrirjes së tij, lumi Lana bashkohet në Laknas me lumin e Tiranës dhe më tej me lumin e Ishmit, për t'u derdhur më tej në deltën e Ishmit në detin Adriatik. Niveli i lartë i ndotjes në lumenjtë që përbëjnë basenin e Ishmit, të cilët bashkohen dhe derdhen të patrajtuar, kanë shkaktuar një situatë të rënduar mjedisore dhe ekologjike në deltën e Ishmit, në afërsi të Kepit të Rodonit.

Gjendja pranë deltës së Ishmit, shkaktuar nga prurjet e lumit, përfshirë këtu edhe mbetje të ngurta urbane etj., të akumuluar nga lumenjtë përbërës, ndër të tjera dhe lumi i Lanës (i cili konsiderohet ndër më të ndoturit pjesë e këtij baseni ujor), paraqitet, si më poshtë:



## Në ambientet e kantierit dhe pjesë përbërëse/ ITUN Kashar



## Qyteti i Tiranës nuk ka një impiant funksional për trajtimin e ujërave të ndotura urbane

Qyteti i Tiranës, me mbi 800 mijë banorë dhe një nga shtatë qytetet më të mëdha në Gadishullin e Ballkanit, nuk ka asnjë trajtim të ujërave të ndotura urbane. Niveli i mbulimit nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane është 0%, në kundërshtim me kërkesat e Direktivës së BE-së 91/271/EEC, që kërkon një mbulim minimal prej 85% për qytetet me më shumë se 10,000 banorë.

Aktualisht, ujërat e ndotura të qytetit të Tiranës shkarkohen në lumin e Lanës, pasi kryeqyteti vijon të jetë pa një impiant funksional. Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN ) në Kashar, parashikuar për të kryer një nivel trajtimi sekondar (për kapacitetin 350,000 p.e) për fazën e parë dhe terciar në nivelin përfundimtar të trajtimit (për kapacitetin 681,680 p.e), është jashtë funksionit.

Punimet e impiantit të Kasharit nisën 10 vite më parë, por institucionet shqiptare ndërprenë në maj të vitit 2018 në mënyrë të njëanshme kontratën e ndërtimit të Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura të Tiranës me kompaninë që u përzgjedh në vitin 2014.

Ndërprerja e kontratës së zbatimit të punimeve për ndërtimin e ITUN Kashar dhe përmirësimin e sistemit të kanalizimeve në qytetin e Tiranës u vlerësua nga Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit (ICC) në Londër si e njëanshme dhe e kundërligjshme, duke arsyetuar se është shkëlur marrëveshja e financimit dhe kushtet e kontratës, duke caktuar në ngarkim të palës së paditur MIE dhe AKUK një vlerë prej afërsisht 13.5 milionë euro. Kostot financiare deri në maturimin dhe shlyerjen e plotë të detyrimeve do të rriten edhe nga aplikimi i interesave vjetore, të përlogaritura në nivelin 3% të normës së skontimit të Bankës përkatëse mbi shumën e principalit të detyrimit të pashlyer. Nga auditimi rezultoi se, deri në datën 30.04.2025, ky vendim nuk ka qenë në proces njohje/ nuk është njohur nga Gjykata e Apelit për të marrë fuqi juridike.

Efektet e këtij vendimi, përfshirë interesat, do të përfaqësojnë një ngarkesë të konsiderueshme financiare për buxhetin e shtetit, ndërkohë që këto fonde buxhetore mund të përdorenshin efektivisht në ndërtimin dhe përfundimin deri në operim të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura në Tiranë, që do t'i jepte një zgjidhje situatës së shkarkimit të ujërave të ndotura urbane të patrajtuara në lumin e Lanës.

Grupi i auditimit realizoi një vizitë në terren në kantierin ku është ndërtuar ITUN Kashar në datën 13.05.2025, në prezencë të përfaqësuesit të AKUK-së, ing. S. Z.



## Mesazhi i auditimit

Institucionet përgjegjëse nuk kanë marrë masa efektive për përmirësimin e cilësisë së ujit në lumin Lana. Raportet e Gjendjes në Mjedis të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit konstatojnë prej vitesh se statusi i cilësisë së ujit në këtë trup ujor klasifikohet në gjendje shumë të ndotur, duke shfaqur përkeqësim edhe në fillim të rrjedhës në Lanabregas përgjatë viteve të fundit. Monitorimi i kryer nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka qenë i pjesshëm, duke mos monitoruar të gjithë stacionet e monitorimit dhe të gjithë treguesit, për të vlerësuar plotësisht cilësinë e ujit dhe statusin ekologjik të lumit Lana. Nga ana tjetër, mungesa e ndërhyrjes nga Bashkia Tiranë dhe Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a. në rrjetin e kanalizimeve, mospërfundimi i investimit për Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura Kashar nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve, si dhe mungesa e ofrimit të zgjidhjeve alternative nga të gjithë këto institucione, ka sjellë që ujërat e ndotura urbane të pjesës më të madhe të qytetit të Tiranës të vijojnë të shkarkohen të patrajtuara, duke ndikuar negativisht në cilësinë e ujit të këtij trupi ujor. Situata aktuale paraqet nevojën për angazhim të menjëhershëm të institucioneve të sipërpërmendura, në zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në përfundim të këtij auditimi, për të garantuar përmirësimin e situatës.

# Auditimi “Shërbimi Psiko-Social në Sistemin Arsimor Parauniversitar” i kryer me SAI-n e Norvegjisë

Është përmbyllur auditimi i performancës me temë “Shërbimi Psiko-Social në Sistemin Arsimor Parauniversitar”, i cili është realizuar me mbështetjen e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Norvegjisë, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit që KLSH ka nënshkruar me këtë institucion.

Auditimi i performancës “Shërbimi psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar” kishte si objektiv kryesor vlerësimin e masave të ndërmarra nga institucionet përgjegjëse dhe efektivitetin e tyre në lidhje me ofrimin e këtij shërbimi nga institucionet publike të arsimit parauniversitar në vend. Auditimi u krye mbi veprimtarinë e institucioneve arsimore për periudhën 01.01.2020 deri më 30.04.2024.


Nga auditimi rezultoi se, sistemi i ngritur nuk garanton shërbim psiko-social të njëjtë dhe gjithëpërfshirës për nxënësit në shkolla, për të mësuar në një mjedis më të sigurt dhe mbështetës. Shërbimi psiko-social aktualisht paraqet një qasje reaguese në vend të ndërhyrjes parandaluese. Ngritja dhe funksionimi i tij nuk garanton mbulim efektiv me shërbim në të gjitha shkollat e vendit. Nga ana tjetër, përfshirja e njëllotjës dhe e pa standardizuar e figurës së psikologut dhe punonjësit social, si dhe kufizimet e vendosura për rekrutimin e psikologut, ka krijuar vështirësi në rekrutime dhe boshllëqe në mbulim. Mbikëqyrja mbi cilësinë e shërbimit dhe plotësimin të infrastrukturës së nevojshme ka munguar duke krijuar hapësirë për zhvillimin e veprimtarisë pa plotësuar standardet e përcaktuara. Koordinim i dobët vihet re mes institucioneve të linjës, ku evidencat e prodhuara mbi shërbimin nuk arrijnë të vlerësohen cilësisht dhe të shkëmbehen në mënyrë të rrjedhshme për t’u përdorur në hartimin e politikave të përshtatshme apo rishikimin e atyre ekzistuese. Strategjitë aktuale të hartuara lidhur me shëndetin mendor, arsimin parauniversitar dhe të drejtat e fëmijëve, trajtojnë pjesërisht dhe në mënyrë sipërfaqësore këtë shërbim. Masat e parashikuara në këto strategji shpesh herë janë të mbivendosura dhe të paqarta mbi mënyrën si duhet të zbatohen nga institucionet në përputhje me fushën e përgjegjësisë së tyre shtetërore. Kuadri rregullator për shërbimin psiko-social është i paharmonizuar, në disa raste kontradiktor me legjislacionin aktual, si dhe vendos barrierë të panevojshme për profesionistët.

## Numri i punonjësve të shërbimit psiko-social në shkolla


Bazuar në urdhrin nr. 313, datë 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social”, i ndryshuar, për çdo shkollë me 500-700 nxënës duhet të punësohet të paktën një punonjës në shërbimin psiko-social. Për çdo shkollë me më shumë se 700 nxënës duhet të punësohen të paktën 2 punonjës të shërbimit psiko-social. Në shkollat ku ka nxënës me aftësi të kufizuara shtohet një punonjës në shërbimin psiko-social nëse numri i tyre është të paktën 10 ose më tepër. Në rastet kur ka shkolla të cilat nuk e arrijnë numrin minimal të nxënësve (pra 500 nxënës), atëherë një punonjës i shërbimit psiko-social i punësuar do të mbulojë më shumë se një shkollë derisa të arrihet të paktën numri minimal i nxënësve (pra 500 nxënës ose më shumë) në varësi të rasteve.

Gjatë periudhës 2014-2024, numri i psikologëve dhe punonjësve socialë të angazhuar në shërbimin psiko-social ka pasur një trend rritës. Në vitin shkollor 2023-2024, në këtë shërbim janë përfshirë gjithsej 824 punonjës ose 558 më shumë krahasuar me vitin shkollor 2014-2015, kur numri i tyre ishte vetëm 266. Megjithatë, pavarësisht rritjes së numrit të punonjësve në shërbim, nga analizimi i të dhënave është vërejtur se ka raste kur nuk sigurohet mbulim i mjaftueshëm me punonjës në shërbim.

## Kriteret për numrin e punonjësve psiko-socialë në shkolla



Në rang vendi, mesatarisht një punonjës i shërbimit psiko-social mbulon 1.7 shkolla. Në nivel DRAP-i, situata paraqitet më problematike në DRAP-in e Fierit dhe atë të Korçës, ku një punonjës i shërbimit psiko-social mbulon respektivisht 2.6 shkolla në Fier dhe 2 shkolla në Korçë. Nga analiza e thelluar e këtyre të dhënave rezultoi se në nivel ZVAP-i ka disa ZVAP që nuk kanë pothuajse fare mbulim me figura profesionale të shërbimit psiko-social.



Nga të dhënat e grumbulluara për shërbimin psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar, për vitin shkollor 2023-2024 rezultoi se:

- Prej 1356 shkollave në vend, rreth 1/4 e tyre ose 334 shkolla nuk kanë mbulim me punonjës socialë apo psikologë, ose rreth 92 991 nxënësve nuk u është ofruar mbështetja e nevojshme psiko-sociale. Përgjithësisht, nxënësit e shkollave në zonat rurale, aty ku edhe mbulimi është pak më i ulët, përballen me më shumë sfida.
- Në zonat rurale kjo gjendje është pasojë e disa faktorëve:
  - Vështirësi në rekrutimin dhe mbajtjen e specialistëve në zonat e thella për shkak të kushteve të vështira të jetesës dhe mungesës së motivimit ekonomik.
  - Mungesa e bashkëpunimit ndërinstucional në nivel vendor për të ofruar shërbime të përbashkëta ndërshkolllore.
  - Përqendrim i ulët institucional dhe monitorimi më i dobët, që çon në zbatueshmëri më të ulët të politikave sociale në këto rajone.
- Megjithatë, edhe në zonat urbane, disa shkolla përballen me sfida për të garantuar mbulim të vazhdueshëm, veçanërisht në periferi të qyteteve të mëdha ose në zona me rritje të shpejtë demografike.

# Për fëmijët me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar nuk ka mbulim me shërbim psiko-social

Numri i punonjësve të shërbimit psiko-social është në varësi të numrit të nxënësve dhe numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara (për çdo 10 nxënës me AK duhet të shtohet një punonjës në shërbim). Në shkollat ku ofrohet shërbimi psiko-social, pjesa më e madhe e nevojave të nxënësve me aftësi ndryshe, duhet të mbulohet nga mbështetja psiko-emocionale dhe vlerësimi i ecurisë së secilit nxënës kryesisht nëpërmjet stafit arsimor dhe mësuesit ndihmës, por edhe nëpërmjet shërbimit psiko-social.

Gjatë auditimit ka rezultuar se për këtë kategori nxënësish nuk është siguruar mbulim, pasi aktualisht nuk janë rekrutuar punonjës shtesë në shërbimin psiko-social në rastet kur ka të paktën 10 fëmijë me AK. Gjithashtu, në disa institucione arsimore ka rritje të ndjeshme të numrit të nxënësve me aftësi të kufizuara, duke arritur deri në 35 nxënës me AK në një institucion të vetëm. Në këto raste, për të mbështetur disi shërbimin janë të punësuar vetëm 2 punonjës të shërbimit psiko-social, të cilët, përveç mbështetjes që ofrojnë për të gjithë nxënësit e institucionit dhe stafin arsimor, kanë në ngarkim edhe ofrimin e shërbimit për këtë kategori specifike të nxënësve.

Nxënësit me AK sipas ZVAP-ve 2023 - 2024

	Totali i nxënësve	Nxënës me AK	% AK ndaj totalit
Tiranë	68,806	1,392	2.02
Fier	10,498	177	1.69
Elbasan	13,775	216	1.57
Durrës ZVAP	18,798	286	1.52
Vlorë	8,017	204	2.54
Korçë	7,469	120	1.61
Lezhë	7,397	91	1.23

Referuar të dhënave të vendosura në dispozicion nga AKAP, aktualisht në vendin tonë ka rreth 4686 nxënës me aftësi të kufizuara për të cilët nuk ofrohet asnjë mbështetje shtesë. Në total, ZVAP Tiranë ka numrin më të madh të nxënësve, rreth 68806, nga të cilët, 1392 janë nxënës me AK, duke përbërë rreth 2.02% të gjithë nxënësve në këtë zonë. Në anën tjetër, ZVAP Vlorë ka përqindjen më të madhe të nxënësve me AK (2.54%), duke treguar se edhe pse ka më pak nxënës në total (8017), numri i fëmijëve me AK është relativisht më i lartë krahasuar me zonat e tjera. ZVAP Lezhë ka përqindjen më të ulët, me vetëm 1.23% të nxënësve që kategorizohen me AK. Megjithatë, evidentohet nevoja për verifikime të dhënash nga ana e strukturave përgjegjëse nëse në këtë rajon ka më pak raste të identifikuara ose të raportuara.

360 650

nxënës studiojnë mesatarisht çdo vit në arsimin parauniversitar në Shqipëri

1356

numri i shkollave në arsimin parauniversitar në vend

824

numri i punonjësve të shërbimit psiko-social në vitin shkollor 2023-2024

50

ZVAP me mbi 10 nxënës me aftësi të kufizuara nuk kanë të punësuar punonjës shtesë të shërbimit psiko-social

92 991

nxënës nuk kanë marrë mbështetje psiko-sociale, pasi ka munguar shërbimi në ¼ e shkollave në rang vendi

4686

nxënës total me aftësi të kufizuara nuk marrin asnjë lloj mbështetjeje psiko-sociale të strukturuar

1392

nxënës, nga 68 806 total në ZVAP Tiranë, janë me aftësi të kufizuara

2750

raste dhune janë regjistruar në sistemin parauniversitar për vitin shkollor 2022-2023

1637

raste dhune janë raportuar/konstatuar në DRAP Durrës, që përbën edhe 59,5% të rasteve në nivel kombëtar

90

raste dhune gjatë vitit 2022-2023 janë raportuar vetëm në një shkollë në Tiranë



80 %

të rasteve janë vetë nxënësit që ushtrojnë dhunë ndaj bashkëmoshatarëve të tyre

## Mesazhi i auditimit

Institucionet përgjegjëse nuk garantojnë shërbim psiko-social të njëjtë dhe gjithëpërfshirës për nxënësit në shkollat e arsimit parauniversitar për të mësuar në një mjedis të sigurt dhe mbështetës. Një pjesë e shkollave, kryesisht në zonat rurale, nuk mbulohe me shërbim psiko-social. Kabinetet dhe mjetet ndihmëse mungojnë, por, dhe kur ato gjenden, në pjesën më të madhe të rasteve nuk janë të dedikuara për specialistët e këtij shërbimi. Ofrimi i shërbimit psiko-social për fëmijët me aftësi të kufizuara nuk kryhet sipas parashikimeve. Dokumentet strategjike në fuqi paraqesin në formë të fragmentuar objektiva për shërbimin psiko-social të cilat shpeshherë janë të mbivendosura. Ndërkohë, kuadri rregullator mbi të cilin është ndërtuar dhe funksionon ky shërbim është i papërshtatur me aktet e tjera ligjore dhe shpesh paraqitet kontradiktor. Megjithëse ndër vite janë ndërmarrë hapa për rritjen e numrit të stafit, shërbimi nuk e përmbush ende funksionin e tij në mënyrë cilësore për identifikimin dhe adresimin e problematikave psiko-sociale.

# Raporti i EUROSAT-t zbulon se si SAI-t evropiane auditojnë qeveritë vendore



Grupi i Punës i EUROSAT-t për Auditimin e Bashkive (Working Group on Municipality Audit - WGMA) ka publikuar një raport gjithëpërfshirës që paraqet rezultatet e një ankete të kryer midis Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) në Evropë lidhur me mandatet dhe praktikat e tyre në auditimin e qeverive vendore.

Ky aktivitet u drejtua nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Estonisë si pjesë e “Planit të Aktiviteteve” të WGMA-së dhe përfshinte përditësimin e hulumtimit mbi sistemet e auditimit të jashtëm. Raporti synon të eksplorojë fushëveprimin e mandateve, funksionet dhe qasjet e SAI-ve në lidhje me auditimet e qeverisjes vendore. Ai shqyrton nëse SAI-t janë të autorizuar ligjërisht për të audituar subjektet vendore, llojet e auditimeve që ato kanë mandat për të kryer dhe produktet që ato publikojnë si dhe sfidat me të cilat përballen në zbatimin e mandateve të tyre. Anketa pritet të kontribuojë në një kuptim më të thellë se si SAI-t mund të rrisin ndikimin e tyre në nivel lokal dhe të mbështesin zhvillimin e institucioneve publike më të përgjegjshme dhe më rezistente.

Raporti përfshin kontributin nga 41 SAI, me informacion të detajuar nga 33 institucione që auditojnë qeveritë vendore, ku 27 SAI janë anëtarë të WGMA-së: Shqipëria, Austria, Azerbajxhani, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Estonia, Gjeorgjia, Greqia, Hungaria, Italia, Izraeli, Kosova, Letonia, Lituania, Malta, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Polonia, Portugalia, Rumania, Serbia, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Turqia dhe Ukraina.

33 Institucione Supreme Auditimi (së bashku me ato që kanë një mandat të plotë - 28 SAI), kanë një mandat për të audituar qeveritë lokale, megjithëse qasjet dhe përgjegjësitë ndryshojnë në vende të ndryshme. 8 SAI raportuan se nuk kanë asnjë mandat për të audituar qeveritë vendore, kjo përgjegjësi kryhet nga institucione të tjera ose auditorë të sektorit privat. 5 SAI kanë mandate të kufizuara, duke u përqendruar vetëm në fusha specifike, p.sh., grantet dhe financimi shtetëror. Kontrolli i Lartë i Shtetit bën pjesë në grupin e SAI-ve që ka mandat dhe kornizë ligjore në auditimin e qeverive vendore.

SAI-t operojnë sipas tre modeleve kryesore: Gjyqësor, Westminster dhe Kolegjial. Shumica (17 SAI) funksionojnë brenda Modelit Westminster dhe theksojnë llogaridhënien parlamentare përmes raportimit publik dhe auditimeve të performancës. Modeli Kolegjial paraqet vendimmarrje kolektive nga një organ shumëanëtarësh (11 SAI). Modeli Gjyqësor integron SAI-t në sistemin ligjor, duke u lejuar atyre të vendosin sanksione dhe të fillojnë procedurat ligjore (5 SAI).

Disa SAI kanë autoritetin ligjor për të filluar procedurat e rikuperimit kur auditimet zbulojnë humbje financiare për shkak të veprimeve të paligjshme ose neglizhencës. Kjo rrit llogaridhënien duke lejuar veprime të drejtpërdrejta për të rikuperuar fondet publike. Midis pjesëmarrësve në anketë, 11 SAI mund të fillojnë veprime rikuperimi, ndërsa 22 SAI nuk kanë këtë mandat. Megjithatë, 18 SAI mund t'i referojnë rastet në autoritete të tjera. Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të auditimit është thelbësor për të siguruar përmirësime reale në administratën publike.

## Appendix A. Mandate and legal framework in auditing LGs

SAI	WGMA membership		Mandate to audit LGs		Monitoring activities		Recovery proceedings		
	Member	Non-member	Full	Partial	Regulated by law	Internal policies/strategies etc.	Yes	No	No, but may refer cases to relevant authorities
Westminster model									
Albania	✓		✓			✓	✓		
Austria	✓		✓	✓	✓	✓	✓	✓	
Bosnia and Herzegovina	✓		✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓

## Appendix B. SAIs' practise and approach in auditing LGs

SAI	Audit types conducted in LGs					Approach in auditing LGs			Audit products		
	Financial	Compliance	Performance	IT	Other	Audited entities, recommendations issued	Information sources	Approach depends on the type of audit	Audit reports	Overviews	Other
Albania	✓	✓	✓	✓	✓				✓		
Azerbaijan	✓	✓	✓								
Austria	✓	✓	✓	✓					✓		
Bosnia and Herzegovina <sup>16</sup>	✓	✓	✓		✓				✓		
Bulgaria	✓	✓	✓		✓				✓		
Croatia	✓	✓	✓	✓	✓				✓		

SAI-t përdorin metoda të ndryshme, kryesisht auditime pasuese (24 SAI) dhe raporte statusi nga qeveritë vendore (20 SAI), por edhe monitorim publik dhe bashkëpunim me ministritë, shumica e SAI-ve i kombinojnë këto qasje.

Pavarësisht se kanë një mandat të qartë, Institucionet Supreme të Auditimit shpesh përballen me sfida në auditimin e qeverive vendore. Pengesa më e zakonshme është kapaciteti i kufizuar, veçanërisht për shkak të burimeve të pamjaftueshme njerëzore, siç është vënë re nga 11 SAI. Disa SAI theksojnë nevojën për mjete të IT-së dhe inteligjencës artificiale për të përmirësuar efikasitetin.

Raporti WGMA-së thekson se Institucionet Supreme të Auditimit luajnë një rol vendimtar në promovimin e transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë në të gjitha nivelet e qeverisjes. Ndërsa decentralizimi vazhdon të formësojë administratën publike në shumë vende, roli i SAI-ve në auditimin e qeverive vendore, siç janë bashkitë, qarqet, është bërë gjithnjë e më i rëndësishëm. Të kuptuarit e fushëveprimit, praktikave dhe sfidave të SAI-ve në auditimin e qeverive vendore në këtë kontekst është thelbësor për forcimin e menaxhimit financiar publik dhe për të siguruar që burimet publike përdoren në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme.

# TRYEZA E NDI ALBANIA

## Bazat e partneritetit konstruktiv mes Nënkomisionit për Auditimin e Sektorit Publik dhe KLSH-së

Në datat 16-17 dhjetor 2025, Instituti Kombëtar Demokratik (National Democratic Institute - NDI) organizoi një tryezë diskutimi me fokus bazat e partneritetit konstruktiv mes Nënkomisionit për Auditimin e Sektorit Publik dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit. Në takim morën pjesë anëtarë të Nënkomisionit për Auditimin e Sektorit Publik, anëtarë të Komisionit për Ekonominë, Punësimin dhe Financat dhe përfaqësues të KLSH-së, përgjegjës për marrëdhëniet me Parlamentin, si dhe ekspertë të NDI-së dhe SIGMA-s. Fillimisht u bë një përmbledhje e punës së Nënkomisionit gjatë vitit 2025 nga ish-kryetarja Emilia Koliqi, e cila paraqiti dhe disa nga problematikat e ndeshura lidhur me mospjesëmarrjen e drejtuesve të institucioneve të audituara në seanca dëgjimore.

Znj. Koliqi vlerësoi bashkëpunimin me KLSH-në për veprimtarinë e punës së Nënkomisionit në vitin e parë.

Z. Anthony Staddon, ekspert i NDI, prezantoi modelet se si e ushtrojnë organe të ngjashme parlamentare funksionin mbikëqyrës mbi përdorimin ekonomik, efektiv dhe eficient të burimeve publike.

Ndërsa z. Alastair Swarbrick, ekspert i SIGMA-s foli mbi sigurimin e një marrëdhënie pune produktive mes KLSH-së dhe Nënkomisionit bazuar në standardet e INTOSAI-t dhe praktikatat e mira ndërkombëtare, në mënyrë që ndjekja e rekomandimeve të auditimeve të ketë ndikim.



Në kuadër të diskutimeve për hartimin e planit të punës së Nënkomisionit për vitin 2026 (përfshirë ndjekjen e rekomandimeve të raportit përfundimtar të Nënkomisionit të korrikut 2025, përzgjedhjen e raporteve të auditimeve që do të shqyrtohen për gjysmën e parë të vitit 2026, seancat dëgjimore me subjektet e audituara etj.), përfaqësuesit e KLSH-së paraqitën një përmbledhje të fushave kryesore të auditimeve për vitin 2026, duke siguruar mbështetje për bashkëpunim me Nënkomisionin dhe Kuvendin e Shqipërisë. Drejtuesja e NDI Albania, Ana Kadovic, theksoi se sigurimi i vazhdimësisë së punës së Nënkomisionit është thelbësor për forcimin e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve dhe përmirësimin e menaxhimit në sektorin publik.

## Bashkëpunim ndërkombëtar për auditimin “Përshtatja e menaxhimit të pyjeve ndaj ndryshimeve klimatike”

Në kuadër të iniciativës së Grupit të Punës së EUROSAT për Auditimet e Mjedisit (EUROSAT WGEA), në datën 4 dhjetor 2025 u zhvillua në Varshavë takimi mbi bashkëpunimin ndërkombëtar për auditimin me temë “Përshtatja e menaxhimit të pyjeve ndaj ndryshimeve klimatike”.

Nevoja në rritje për të mbrojtur pyjet dhe ndërmarrë masa ndaj ndryshimeve klimatike, roli i institucioneve supreme të auditimit në vlerësimin e integritetit të veprimeve qeveritare dhe në mbështetjen e tranzicionit të ekonomive kombëtare drejt zhvillimit të qëndrueshëm është me rëndësi thelbësore.

Përgjatë takimit u prezantua një material nga Prof. Bogdan Jaroszewicz i Universitetit të Varshavës për përshtatjen e menaxhimit të pyjeve nga impakti i ndryshimeve klimatike. Nga SAI i Polonisë, i cili mban edhe drejtimin EUROSAT WGEA u prezantua edhe një auditim i realizuar me temë “Përshtatja e menaxhimit pyjor të Pyjeve Shtetërore ndaj ndryshimeve klimatike”. SAI-t pjesëmarrëse paraqitën shkurtimisht të dhëna mbi funksionimin dhe strukturat e menaxhimit të pyjeve në vendet përkatëse.

Krahas SAI-ve të Bullgarisë, Kroacisë, Letonisë, Litanisë, Sllovakisë dhe Sllovenisë, të cilët kanë shprehur interesin për t’iu bashkuar kësaj iniciative, edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit konfirmoi pjesëmarrjen në këtë angazhim ndërkombëtar duke konsideruar rëndësinë e kësaj teme. Në këtë aktivitet ku merrnin pjesë përfaqësues nga SAI të ndryshëm të Evropës, KLSH u përfaqësua nga drejtori i Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore dhe Pronës Publike, z. Agron Halili dhe audituesit, z. Petrit Imeraj dhe z. Shkëlzen Hoxha.



# Botohet Buletini Vjetor mbi veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit gjatë vitit 2025

## KLSH, më pranë publikut dhe grupeve të interesit

Botohet “Buletini Vjetor” mbi veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit gjatë vitit 2025.

Për të garantuar një komunikim sa më efikas dhe transparent me publikun dhe grupet e interesit, Kontrolli i Lartë i Shtetit nisi në muajin nëntor 2024 publikimin e materialit informues “Buletini Mujor”. Ky format i ri komunikimi synon të afrojë më shumë institucionin me publikun, duke ofruar informacione të qarta dhe të strukturuar mbi punën e KLSH-së.

Botimi i “Buletinit Vjetor” sjell në një dokument të vetëm 13 numrat e buletinit mujor (nëntor 2024 - nëntor 2025). Botimi përmban aktivitetet kryesore të institucionit, rezultatet më të rëndësishme të auditimeve, si dhe bashkëpunimet me institucionet vendase dhe ndërkombëtare të auditimit, duke ofruar një pasqyrë të integruar të punës së KLSH-së përgjatë vitit.

“Buletini Vjetor” shërben si një instrument orientues për publikun, institucionet partnere dhe çdo aktor të interesuar dhe, njëkohësisht, si arkiv i përditësuar i veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Përmes tij, institucioni synon të forcojë kulturën e informimit, të rrisë ndërgjegjësimin publik mbi rolin dhe misionin e auditimit të jashtëm publik dhe të avancojë më tej standardet e transparencës në qeverisjen publike. Botimi mund të aksesohet në linkun:







<https://www.klsh.org.al/wp-content/uploads/2025/12/Buletini-Vjetor-2025-2.pdf>

*“Transparenca është një nga shtyllat kryesore të misionit tonë institucional. Nëpërmjet informimit të vazhdueshëm dhe të besueshëm, ne synojmë të forcojmë besimin e qytetarëve dhe të sigurojmë një pasqyrë të qartë mbi veprimtarinë e institucionit, proceset dhe angazhimet tona. Publikimi i buletinit mujor dhe përmbledhja vjetore e tij përfaqësojnë angazhimin tonë për të komunikuar hapur, për të forcuar llogaridhënien dhe për të ndërtuar një dialog të qëndrueshëm me publikun dhe grupet e interesit. Informimi i publikut nuk është thjesht detyrim ligjor, por një angazhim i qëndrueshëm për llogaridhënie dhe integritet.”*



Falënderit për leximin!

© Të gjitha të drejtat e rezervuara nga KLSH

 <a href="http://www.klsh.org.al">www.klsh.org.al</a>	 Kontrolli i Lartë i Shtetit
 E-mail: <a href="mailto:klsh@klsh.org.al">klsh@klsh.org.al</a> <a href="mailto:info@klsh.org.al">info@klsh.org.al</a>	 <a href="https://www.instagram.com/klsh_org_al">klsh_org_al</a> (KLSH) Albanian Supreme Audit Institution
 Rruga “Abdi Toptani” Nr.1 Tiranë	 Orari pritjeve për publikun: E hënë – E enjte: 08:00 – 16:30 E premte: 08:00 – 14:00